

Raport për rezultatet e konsultimeve publike për:

“Për Strategjinë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 dhe të Planit të Veprimit 2026-2028”

1. Titulli i projektaktit

“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 dhe të Planit të Veprimit 2026-2028”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektakti është hartuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Draft Strategjia Kombëtare kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2024-2030 është hartuar dhe koordinuar nga Ministria e Punëve të Brendshme me kontributin e Grupit të Punës të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 96, datë 17.6.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 dhe të Planit të Veprimit 2026-2028”.

Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 dhe Plani i Veprimit 2026-2028 në zbatim të saj, u hartua në përputhje dhe harmoni të plotë me metodologjinë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 - 2030. Konkretisht në shtyllën e parë të SKZHIE 2030 “Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë”, është parashtruar nevoja e forcimit të mëtejshëm të institucioneve efikase të vendit si bazë që siguron demokracinë, konkurrencën dhe zhvillimin ekonomik të vendit duke e përgatitur atë për anëtarësim në BE. Në këtë shtyllë është parashikuar lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit si një ndër komponentët përbërës të saj.

Qëllimi strategjik në fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda i parashikuar në SKZHIE 2030 është “Garantimi i një mjedisi të sigurt për zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë nga kërcënimet e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke siguruar jetën e individit, sipërmarrjen e lirë dhe respektimin e ligjshmërisë në tërësi”.

Hartimi i kësaj strategjie është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent konsultimi ndërmjet institucioneve publike, agjencive të zbatimit të ligjit, sistemit të drejtësisë, aktorëve të shoqërisë civile, qytetarëve, grupet e interesit, organizatat e specializuara dhe institucionet publike që kanë rol në fushën e krimit të organizuar dhe

krimeve të rënda dhe sundimit të ligjit, ku mund të përmendim: strukturat e varësisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, AAPSK), Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe e Inovacionit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Arsimit, Ministria e Mjedisit, Ministër i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjike dhe Koordinimit të Ndihmës, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Pasurive Kulturore, Shërbimi Informativ i Shtetit, Banka e Shqipërisë, Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, OJQ dhe Organizma Ndërkombëtarë (ICITAP, Këshilli i Evropës, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri), media.

Këto konsultime kanë ndihmuar në identifikimin e prioritetëve kombëtarë, në përmirësimin e draftit të strategjisë dhe në garantimin e një baze të gjerë konsensusi dhe mbështetjeje institucionale dhe nga partnerët ndërkombëtarë apo donatorët për masat e propozuara. Gjithashtu, procesi i konsultimit publik është zhvilluar në përputhje me kornizën e transparencës dhe pjesëmarrjes së parashikuar nga legjislacioni shqiptar duke mundësuar komente, sugjerime dhe rekomandime nga publiku i gjerë dhe partnerët social nëpërmjet platformave elektronike dhe komunikimeve zyrtare. Kjo ka garantuar jo vetëm legjitimitet demokratik, por edhe një qasje të integruar dhe praktike në hartimin e strategjisë, duke reflektuar realisht nevojat dhe sfidat aktuale të identifikuara në terren.

Gjithashtu, projektvendimi u publikua në RENJKP në periudhën 15.10.2025 deri në datë 12.11.2025, nga ku rezultoi se u aksesua 559 herë nga publiku, por pa komente në platformë.

Ministria e Punëve të Brendshme e ka shpërndarë edhe përmes emailit paketën e plotë të projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 dhe Planit të Veprimit 2026-2028” me organizatat partnere të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ose po zbatojnë projekte në fushën e parandalimit dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda si GIZ, ICITAP, OSCE, UNDP, EU4LEA, Forensic for Albania.

Në kuadër të platformës së partneritetit ndërinstitutional, përmes emailit, paketa e plotë e projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 dhe Planit të Veprimit 2026-2028” është shpërndarë për konsultim edhe tek 29 aktorë (OJF, akademikë, ekspertë të pavarur etj.) pjesë e kësaj platforme, të ngritur në bazë të urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për integrimin evropian”, me qëllim

konsultimin, por edhe informimin, komunikimin dhe përfshirjen gjithnjë e më të madhe të grupeve të interesit dhe aktorëve jo-shtetërorë në proces.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 dhe të Planit të Veprimit 2026-2028”, janë si më poshtë:

1. Takime me grupin e punës në zbatim të urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 96, datë 17.6.2025;
2. Platforma e-Akte, si mënyrë e mendimmarrjes mes institucioneve të linjës;
3. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet;
4. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike) në bazë të urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për integrimin evropian”, dërgim i paketës së plotë tek 29 aktorë (OJF, akademikë, ekspertë të pavarur, etj) pjesë e kësaj platforme;
5. Komunikime dhe konsultime me organizatat partnere.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit. Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese. Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë gjithë procesit, janë:

- Anëtarët e grupit të punës ngritur me Urdhrin nr. 96, datë 17.6.2025 të Ministrit të Brendshëm “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare

kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 dhe të Planit të Veprimit 2026-2028”;

- Drejtori dhe punonjësit e Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator;
- Drejtori dhe punonjësit e Drejtorisë së Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike;
- Ekspertët e fushës dhe partnerët ndërkombëtar;
- 29 aktorë (OJF, akademikë, ekspertë të pavarur, etj) pjesë e platformës së partneritetit ndër-institucional;
- Koordinatorin për konsultimin publik në MPB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi	Justifikimi
(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	(grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	(Pranuar/Pranuar pjesërisht/Refuzuar)	
Në lidhje me hyrjen dhe qëllimin e dokumentit	Është theksuar se mungon përfshirja e perspektivës gjinore dhe analiza e ndikimit të krimit të organizuar mbi grupet vulnerabël, si gratë, të rinjtë dhe minoritetet. Sugjerohet integrimi i parimeve të Bashkimit Evropian për “gender mainstreaming” në politikën e sigurisë dhe dokumentet strategjike.	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Pranuar	Sugjerimi është pranuar dhe është përfshirë në dokumentin e strategjisë.

Në lidhje me analizën e riskut	Është evidentuar se nuk përfshihet vlerësimi i ndikimit të krimit të organizuar mbi grupet e cenueshme, duke kufizuar identifikimin e nevojave specifike për masa parandaluese dhe ndërhyrje sociale.	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Refuzuar	Sa i përket këtij komenti, ju informojmë se është refuzuar, pasi në dokumentin e strategjisë janë përfshirë gjetjet e vlerësimit të krimit të organizuar dhe analizat e hartuara nga institucionet duke përfshirë këtu SPAK, PSH, PP, AIF dhe SHISH. Gjithashtu janë marrë parasysh gjetjet e raportit analitik “Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit të Organizuar dhe të Rëndë”/SOCTA i cili është një raport analitik strategjik, i hartuar mbi bazën e informacionit të përditësuar dhe metodave bashkëkohore të analizës, ku identifikohen, analizohen dhe vlerësohen kërcënimet që
--------------------------------	---	--	----------	--

				vijnë nga krimi i organizuar dhe i rëndë. Ky raport është një vlerësim kërcënimi i së tashmes, i orientuar nga e ardhmja, që mbështetet në analiza gjithëpërfshirëse cilësore dhe sasore të fokusuara në tre aspekte a) grupet kriminale; b) fushat e krimit të organizuar dhe të rëndë; c) mjedisi i gjerë në të cilin veprojnë dhe zhvillojnë aktivitet individë dhe grupe kriminale.
Në lidhje me Qëllimin Strategjik I	Është vënë në dukje se masat parandaluese nuk diferencohen qartë nga masat goditëse, çka krijon paqartësi në strukturën e strategjisë dhe në ndarjen logjike të ndërhyrjeve.	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Pranuar	Sugjerimi është pranuar dhe janë bërë ndërhyrjet e nevojshme në dokumentin strategjik për të bërë të dukshëm dallimin në strukturën e strategjisë mes masave parandaluese dhe atyre goditëse
Në lidhje me Qëllimin Strategjik II	është theksuar se objektivat janë të formuluar në mënyrë	Partnerët Shqipëri për	Pranuar pjesërisht	Objektivat specifike janë riformuluar

	të përgjithshme dhe nuk shoqërohen me tregues matës për vlerësimin e progresit institucional. Gjithashtu, mungon trajtimi i mbrojtjes së të dhënave personale.	Ndryshim dhe Zhvillim		sërish ndërsa sa i përket komentit ku evidentohet se objektivat janë të formuluar në mënyrë të përgjithshme dhe nuk shoqërohen me tregues matës për vlerësimin e progresit institucional, sqarojmë se strategjia shoqërohet nga aneksi i indikatorëve të performacës për çdo objektiv specifik të shtrirë në të gjithë periudhën e zbatimit të tyre dhe me vlera të synuara të përcaktuara me qëllim matjen e progresit në raport me vlerën e vitit bazë 2025.
Në lidhje me Objektivin Strategjik 2.4 – Krimet kibernetike	Është konstatuar se nuk trajtohet aspekti i privatësisë dhe sigurisë së të dhënave personale gjatë proceseve hetimore, në përputhje me standardet e BE-së.	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Pranuar	Aspekti i privatësisë dhe sigurisë së të dhënave personale është përfshirë në objektivin specifik 2.4 Në strategji është përfshire

				një seksion i dedikuar (Aneksi 1) për kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave dhe përputhshmëria me standartet e BE-së.
Në lidhje me Objektivin Strategjik 2.8 – Krimi mjedisor	Është theksuar se mungon dimension i social dhe gjinor i ndikimit të këtij fenomeni mbi komunitetet dhe grupet vulnerabël.	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Pranuar	Aspekti i dimensionit social dhe gjinor është përfshirë në objektivin specifik 2.8
Në lidhje me Pjesën III – Zbatimi dhe monitorimi	Është evidentuar se nuk parashikohet një mekanizëm i pavarur mbikëqyrës, si dhe mungon përfshirja e indikatorëve gjinorë dhe detyrimi për publikimin periodik të të dhënave.	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Pranuar	Aspekti i indikatorëve gjinorë është përfshirë në strategji dhe do të operacionalizohet në bashkëpunim me UN Women, duke u mbështetur në projektet e saj aktuale dhe të përfunduara, të zbatuara me institucionet shqiptare të përfshira në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar. Sa i përket mekanizmit të pavarur mbikëqyrës, për

				monitorimin e strategjisë është parashikuar se Ministria e Punëve të Brendshme do të krijojë një mekanizëm formal përfshirje të përfaqësuesve të shoqërisë civile, përfaqësues të institucioneve akademike, aktorëve të platformës së partneritetit, përfaqësues të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare që kontribuojnë, implementojnë projekte ose ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e parandalimit dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë.
Në lidhje me Qëllimin Strategjik III – Bashkëpunim	është vënë në dukje se bashkëpunimi përmendet në mënyrë të përgjithshme, pa referenca të qarta ndaj standardeve të	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Pranuar	Pranuar dhe reflektuar në strategji

i ndërkombëtar	Bashkimit Evropian për shkëmbimin e sigurt të të dhënave dhe mbrojtjen e privatësisë.			
Në lidhje me monitorimin dhe raportimin	Është theksuar se nuk parashikohet publikimi periodik i raporteve dhe përfshirja e shoqërisë civile, duke kufizuar transparencën dhe llogaridhënien.	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Pranuar	Në strategji është parashikuar se të gjitha raportet 6-mujore, vjetore dhe raporti i vlerësimit përfundimtar do të bëhen publike. Në rast se raportet përmbajnë të dhëna konfidenciale do të përgatitet një version për publikim.
Në lidhje me vizionin e strategjisë (pika 1.2)	Është sugjeruar riformulimi i tij për të përfshirë në mënyrë eksplicite organizatat jofitimprurëse, krahas qeverisë, sektorit privat, komunitetit dhe qytetarëve.	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Pranuar	Komenti është pasqyruar në strategji.
Në lidhje me Objektivin Specifik 1.1	Është theksuar nevoja për saktësimin e termit “aktorë të tjerë”, me qëllim qartësimin e roleve në fushatat ndërgjegjësuese.	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Pranuar	Komenti është pasqyruar në strategji.
Në lidhje me Objektivin Specifik 1.2	Është sugjeruar forcimi i bashkëpunimit me sektorin e OJF-ve dhe përmirësimi i kuadrit ligjor për kalimin në pronësi të njësive të qeverisjes vendore të pronave të konfiskuara,	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Pranuar	Komenti është pasqyruar në strategji.

	me qëllim ripërdorimin social të tyre.			
Në lidhje me Objektivin Specifik 2.3	Është theksuar se trajnimet duhet të adresojnë në mënyrë më të qartë rrezikun e abuzimit të OJF-ve për pastrim parash dhe financim të terrorizmit.	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Pranuar	Komenti është pasqyruar në strategji.
Në lidhje me Objektivin Specifik 2.6	Është sugjeruar që qasja strategjike të përfshijë në mënyrë eksplicite ripërdorimin social të aseteve të konfiskuara, përfshirë përdorimin e pasurive të paluajtshme për qëllime sociale dhe sipërmarrje sociale.	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Pranuar	Komenti është pasqyruar në strategji.
Në lidhje me regjistrin elektronik të pasurive	Është theksuar nevoja për saktësimin e terminologjisë “pasuri të sekuestruara dhe të konfiskuara”, si dhe përmirësimin e elementeve funksionale të këtij regjistri.	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Pranuar	Komenti është pasqyruar në strategji.
Në lidhje me vlerësimin përfundimtar dhe publikimin e raporteve	Është sugjeruar parashikimi i një seksioni të posaçëm për publikimin, ku të gjitha raportet 6-mujore, vjetore dhe raporti i vlerësimit përfundimtar të bëhen publike, duke garantuar versione të përshtatura për publikim në rast të të dhënave konfidenciale.	Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	Pranuar	Në strategji është parashikuar se të gjitha raportet 6-mujore, vjetore dhe raporti i vlerësimit përfundimtar do të bëhen publike. Në rast se raportet përmbajnë të dhëna konfidenciale do të përgatitet një version për publikim.

Në lidhje me krijimin e një qasje administrative	Është propozuar zhvillimi dhe zbatimi i një qasje të integruar administrative për parandalimin dhe dobësimin e strukturave kriminale, përmes përdorimit të instrumenteve administrative, fiskale, tatimore, inspektuese dhe të licencimit, si dhe përmes bashkëpunimit ndërinstitucional midis agjencive ligjzbatuese dhe atyre ekonomike e rregullatore.	Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes	Pranuar	Propozimi si edhe konteksti i tij mbështetës është reflektuar në dokumentet strategjike (draft-strategjia dhe plani i veprimit), konkretisht duke krijuar objektivin specifik 1.6 me masat e propozuara dhe të buxhetuara nga CSDG. Ky objektivi specifik ka parashikuar 4 masa specifike.
--	---	--	---------	--